



**VENDIM**

**Nr. 56 Datë 22.06.2011**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES E HEC ASHTA SI  
BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, dhe nenit 9 pikat 1 dhe 2 /“a” të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 22.06.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues HEC “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmerinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë Energji Ashta sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues Hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s  
NE DETYRE  
Entela SHEHAJ**